

SKËNDER RUSI
EDHE PERËNDITË E DUAN LAVDINË
LIRIKA

BOTIMET TOENA

Skënder Rusi

Edhe perënditë
e duan lavdinë

Lirika

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor letrar: Dr. Eris Rusi

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-26-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Ky libër të kushtohet ty Egla,
që je kryelirika ime.*

Mirënjohja është kujtesë e zemrës, ndaj ky libër vjen në shenjë falënderimi të singertë për të gjithë të afërmit, miqtë, lexuesit e njohur dhe të panjohur, në Shqipëri dhe në Amerikë, të cilët mbështetën financiarisht botimin e tij!

Autori

Dy fjalë për lexuesin

Të shkruash për poetin, duke e pasur të shtrenjtë njeriun, është një përpjekje sa interesante, po aq edhe e vështirë nga pozicioni im, që është ai i një biri që shkruan për të atin, por edhe i një lexuesi që preket nga hapësira poetike e këtij libri. Gjatë gjithë këtyre viteve, kam menduar se Poeti, mes njerëzish të tjerë, është më i habitshmi gjatë krejt jetës së tij. Atij mund t'i vendosësh në brendësi shkronjat e alfabetit, formulat matematikore, ligjet, detyrat, përgjegjësitë, urdhrat, ato që duhet të bëjë dhe ato që ende nuk i ka bërë e, çuditërisht, mundet të dalin prej tij, përveç gjithë këtyre, buzëqeshje, ëndrra, poezi, nga ato që të bëjnë të ndihesh i gjallë e i plotë. Akti i krijimit dhe teksti që botohet më tej, janë përligjje e ekzistencës njerëzore të tij.

Por nuk është vetëm kaq. Tek im atë unë mund të njoh shenjat e asaj çka janë njëherësh, e habitshmja dhe e dhembshura, një lloj perëndimi i trishtë tek ato vargje ku në vend të diellit që ngroh botën, depërton pëshpërime e muzgut, jo e jetës, po e kësaj bote që ka nisur të ngjasojë e marrë.

E tillë është, derisa njerëzit nuk po njohin dot më të bukurën dhe shpirtëroren, por vrapojnë nëpër ditë të mbrapshta, sikur kuptimi i jetës të jetë vetëm të shkuarit në fund të saj.

Kaq e panatyrshme është kjo jetë, që po na ikën në këtë mënyrë, sa unë arrij ta gjej pak nga shpengimi i hershëm i buzëqeshjes së botës, te Skënder Rusi dhe bota poetike e tij.

Ndaj po e nis nga titulli i këtij libri. *Edhe perënditë e duan lavdinë*, por sidomos njerëzit, pa dyshim ata, e mbi të gjitha krijuesit, një pjesë e atyre që jetojnë si në ëndërr dhe që shtyhen drejt qaceve të largëta, midis të pamundurës dhe shpirtërores. Kjo pjesë është diçka më tepër, më e madhe sesa vetë jeta e poetit, pasi nuk është vetëm përkuqdes ndaj ditëve të jetuara, por shfaqet si një vëmendje ndaj fjalës, e cila, te Skënderi Rusi, lidhet ngushtë me **misterin** që na prek pak a shumë të gjithëve: përse jetojmë, dhe ç' vend duhet të zërë e bukura në ekzistencën e secilit prej nesh?

Prandaj ky libër nuk është vetëm një libër që vjen sot te lexuesi, që i përgjigjet nevojës që ka poeti për t'u ndier i domosdoshëm në jetë, është diçka më shumë. Nuk kemi të bëjmë vetëm me atë që mund ta cilësojmë si **nevoja e komunikimit poetik**. Kushdo që ka jo vetëm mendimet dhe përfytyrimin e mendjes, por edhe emocionin e shpirtit, e kupton që poezia mund të këmbehet me vetë jetën, me atë ekzistencë të mbërthyer në një fluks fjalësh që të bëjnë të duash dhe të ndiesh. Misteri, ëndrrat, lumturia dhe përjetësia, së bashku me refleksin e kundërt të gjithë këtyre: e dukshmja, makthet, palumturia dhe përkohshmëria, kështu ngjajnë të krijuara rrugët që çelen nga lirikat e këtij libri.

*Mos u habitni që vetëm nxitojmë,
Jemi stuhi, jo vetëm fllad,
Një botë të re ne do ndriçojmë,
Asgjë më tepër,
Asgjë më pak!*

E këto nuk janë thjesht fjalë. Janë rrugë që shtrohen nga misteri që nis prej zemrës, kalon në frikën dhe ankthin e njeriut, e shtyhet përtej, në hapësirën ku aq shumë janë ngritur

vështrimet tona edhe në ditë të zbrazëta nga shpresa, e prapë kemi pëshpëritur lutje që dëgjohen veç prej nesh.

Njeriu përjeton stuhitë e tij, mbi të gjitha ankthin e vetmisë dhe frikën e vdekjes, por patjetër edhe hovin që kthehet në dashuri dhe e bën të përhershme buzëqeshjen. Poeti Skënder Rusi është një rrebesh flakërimë, gjënimet që derdhen prej tij nuk dalin nga njeriu, por nga poeti. Nëse njeriu është i qetë, i ngrohtë, i buzëqeshur, i dhembshur, poeti është përtej kësaj, është përjetësi dhe tjetërkohë njëkohësisht. Ndaj rrebeshet në këtë libër vijnë nga një qiell tjetërbote, i mbushur me mjegull e erë, që sheh poshtë jo tokën, por një vijë të tejdukshme: një horizont shpirtrash, ku jam dhe unë, ku je dhe ti, që ulet dhe ngrihet si baticat dhe tërheqjet e një deti në dhimbje. Vetëm kështu poezia nuk njeh kufij, shtyhet përtej të zakonshmes, të çon aty ku duhet, në vendtakim me ëndrrat tona të hershme apo të nesërme, derisa çlodhemi, zgjohemi të harruar e kujtojmë si pjesë të vetes, mallëngjimin.

*Kërkoj të futem brenda syve të tu,
Dhe kjo me asnjë kusht, natyrisht,
Përgashta po bie dëborë blu,
Nuk është dëborë, po shpirt!*

Pse ky ndryshim i rendit të zakonshëm që ne e njohim në botë? Kufiri i poetikes është misterioz, ndaj bora nuk është e bardhë, por blu, pritja nuk është padurim, por prangosje, jeta nuk është e tillë pa vdekjen në krah. E ndoshta për të shpjeguar poezinë e Skënder Rusit, duhet që secili prej nesh të kapet tek ai nxitim i **mistershëm**, pas asaj lëvizjeje që do të thotë jetë, por edhe pasiguri, orientim kah diçkaje që nuk perceptohet dot lehtë brenda fjalës, por që të prek e të nxit të ndiesh, të përjetosh botën dhe udhëtimin, njëlloj siç e bën poeti në vargjet e tij.

Babai im nxiton dhe ka një ecje të veçantë edhe në jetën e tij reale. Asnjëherë kjo nuk mund të jetë e drejtë dhe e ndershme me njerëzit e drejtë dhe të ndershëm, ndaj ai vrapon, që të mos lërë t'i bjerë prej vetes as edhe një nga këto ditë të djeshme, që nuk janë vetëm kujtim, por edhe mister. Por hapat e tij nuk vrapojnë për t'i shpëtuar jetës, miqve, familjes, por ka qenë vetë jeta që e ka ndërtuar të tillë. Një burrë njerëzor me krejt dhimbjen që i pikon mbi vete, e ai nuk e fsheh atë, pasi dhimbja është hijeshi. Kështu dashuron poeti. Krah tij është jo vetëm imazhi i asaj që tingëllon si krijim, por edhe bashkëshortja e tij, nëna ime, që

di të ngatërrohet në mërmërimat e shpirtit,
si për t'i thënë: mos nxito, i dashur, kemi
akoma shumë hapa të tjerë për të hedhur
bashkë, mbi re e mbi tokë.

Tek e djeshmja dhe tek ajo që pritet të
ndodhë, ka një lidhje të tejdukshme që e bën
misterioze vetë ekzistencën tonë.

*Këtë njeri e dija të vdekur,
E pashë brenda një dielli
Që kish perënduar,
Ai fliste sikur të kish gjetur
Natën e tij, por pa mua!*

Gjithçka është e mistershme, jeta, mbrëmjet e saj, njerëzit që i kemi rreth e rrotull e që ndonjëherë na befasojnë, na bëjnë të ndihemi të veçantë, na përmallin apo na shtyjnë të besojmë që vendi ynë, në këtë botë, është i lidhur ngushtë me mënyrën se sa fort na vlerësojnë dhe mbështetin miqtë, shokët, të afërmit, por edhe të panjohurit e largët, lexuesit që nuk i kemi takuar asnjëherë, lexuesit e jetës sonë, që ende nuk kanë lexuar sa duhet nga ekzistenca jonë. Mister është sëmundja, lodhja, vdekja, koha e dreqosur, që si një sfinks nuk po vendos dot një pajtim mes asaj çka ndiejmë, e asaj çka na duhet

të kapërdijmë për të mos folur fare. Jemi përballë një përmbysjeje të madhe, ndaj dhe zgjimi ynë mund të ngjasojë ose do të ndodhë të jetë një ditë, **apokaliptik**:

*U zgjova në mëngjes
Dhe pashë që bota kishte ikur,
Domethënë fushat, malet, lumenjtë,
Kish mbetur vetëm një copëz vend për mua,
Dhe një copëz qiell i kadifenjtë!*

Tmerri që mund të përjetohet nga vetmia që vjen pas gjëmës dhe apokalipsit, është edhe një ngacmim për të prekur me njërën dorë qiellin e mëngjesit, e me tjetrën muzgun që vjen e afron harresën mbi veten tonë.

I vetmuar, babai im, nuk ka qenë asnjëherë në jetën fizike të tij. Është familja e tij, miqtë, të njohurit, por vetmia e poetit është një zgavër e madhe shpirti, diçka që zor se tejshkohet nga mendimet që na lindin në kokë përditshmërisht.

Vetmia, që është jo vetëmohim, por më tepër se kaq. Ndërsa së jashtmi kumbon emri, fama, njohja. Kur përmendim lavdinë, që është mishërim i asaj çka cilido kërkon të arrijë me jetën e tij, nuk duhet të mos mendojmë për vdekjen dhe fundin, që zbret pashmang-

shmërisht mbi jetën e kujtdo. Poeti portugez Fernando Pessoa, shkruan diku se ***“Vdekja është kthesa e rrugës. Të vdesësh, do të thotë thjesht që nuk të shohin dot më”***.

Ndërsa me poezinë e tij Skënderi kërkon të tregojë që përjetësia nuk është më larg sesa kjo kthesë e rrugës sonë, e në vend që të tristohemi, mund edhe të dashurojmë:

*Një zjarr i kaltër mbete ti,
Që nuk më ngroh,
Po veç më djeg!
Ti, brenda meje flaka je,
Tek ajo pjesë që vetëm dhemb!*

Flakë dhe dhimbje, e jetë. Dheu, që përbëhet prej qiellit, në këtë dritë mendoj që duhet të shohim çdo poet që krijon për dashurinë. Të tilla janë lirikat e këtij libri ku puthjet nuk janë vetëm puthje, e përqafimet nuk mbeten asnjëherë vetëm përqafim. Intimiteti personal shpejt ndryshon dhe kthehet në një ndjesi që çdo lexues mund ta kalojë mbi vete:

*Ka ditë kur unë jam vërtet i mërzitur,
Absurde më duket çdo gjë që prek,
Asnjë rrugë
Nuk ma ngre dorën për të ikur,*

*Asnjë njeri
Që ka zyrë s'më përshëndet!*

*Është një heshtje
që flet më tepër se fjala
(Heshtje e njerëzve të thjeshtë).
Ata nuk i shkelin vijat e bardha,
Ecin në shtratin e tyre si lumenjtë!*

Poeti, kështu, zgjedh një mbivendosje të së veçantës me të përgjithshmen, dhimbja te përjetësia, nga koha që nuk kthehet dot pas te besimi, pranë qiellit dhe perëndive, në mërmërimat e shpirtit dhe tek e mistershmbja e jetës.

Në këtë mënyrë, lirikat lidhen e marrin një formë ciklike, ku mund të dallohet kureshtja, që njeriu të ushqejë kujdes ndaj të kaluarës dhe jetës që pasqyron atje. Ne jemi njerëz që dimë të harrojmë shpejt, e ky ndoshta është një ves i padurueshëm, ndaj ky libër këmbëngul që të mos sfumohen përjetimet, emrat dhe fytyrat, lexuesi ngacmohet të ndiejë pranë të ëmbilin e zemrës apo të dashurën e shpirtit.

Në mbyllje, dua të shtroj para jush një pyetje, që vazhdoj t'ia bëj me këmbëngulje vetes: si ka mundësi që vazhdon të shkruajë

dhe nuk lodhet, babai im? Nuk i ka thënë të gjitha? Akoma kërkon te misteri i fjalës, shërimin e shpirtit?

S'ka dyshim që po, është përgjigjja. Ai do të shkruajë. Edhe kur të duket sikur dora nuk do t'i bindet dhe zemra do t'i përngjajë një disku vezullues që nuk është diell, por dhimbje, ai do të shkruajë. E jeta e tij ka për të qenë përherë një tekst i gjatë ndjesish e shpërthimesh, një lëndinë e blertë lirikash e përfytyrimi poetik, sepse gjithë ekzistenca e Skënder Rusit është një letër e bardhë, që ai e mbush me shkrimin që është rebel njëlloj si dikur.

Im atë, krijuesi, që më ngroh jetën e ma bën të jetë e kaltër ekzistenca kur e lexoj, Ai është krijues, ndaj dhe Perëndi. E nëse në jetën reale gjithmonë mund ta shohësh tek lëviz me hapa të shpejtë e të thjeshtë nëpër kalldrëmet e ditëve, o Zot, te vargjet që krijon është pak Perëndi! E si i tillë, poezia që bën, e meriton lavdinë!

Eris Rusi

Pushtimi i botës

Unë me ty do të pushtoj botën,
Jo si dy zjarre që marrin hak,
Por si dy njerëz me të njëjtin fat!
Asgjë më tepër,
Asgjë më pak!

Sa të rëndë që e paskam kokën,
Sikur ma kanë mbyllur me kapak,
Ne të dy do ta mposhtim botën,
Asgjë më tepër,
Asgjë më pak!

S'ngatërrohem me mediokër,
Dhe kemi për të shkuar shumë larg!
Ku çdo njeri vlen sa kjo botë,
Asgjë më tepër,
Asgjë më pak!

Mos u habitni që vetëm nxitojmë,
Jemi stuhi, jo vetëm filad,
Një botë të re ne po ndërtojmë,
Asgjë më tepër,
Asgjë më pak!

Nuk po gjej kohë as për të vdekur

Ti je më e mirë se unë,
Edhe sytë më të bukur i ke!
Je pakëz det e pakëz lumë,
Në ujërat e tua më fsheh!

Ti je e bija e muzgut,
Njihesh këtu e lart mbi re,
Njih nga afër atë që s'është e mundur,
Ajo që është e mundur ty të njeh!

Ti je edhe më qiellore se unë,
Vishesh trendi si asnjë tjetër,
Tani e tutje, e ndoshta kurrë,
Nuk i vijnë njeriut të tillë njerëz!

Ti je më e mirë se unë,
Në sytë e tu zjarre unë kam ndezur,
Nuk pata kohë të të doja më shumë,
Tani s'po gjej as kohë për të vdekur!

23 maj 2018

Dëbora blu

Kërkoj të futem brenda syve të tu,
Dhe kjo me asnjë kusht, natyrisht,
Përjashta po bie dëborë blu,
Nuk është dëborë, po shpirt!

Trokas në portën që atje më shpie,
Te sytë e tu të mëdhenj,
Bie dëborë blu, vazhdon e bie,
Është shpirti im që dhemb!

Brenda syve të tu, edhe unë
Kërkoj pa asnjë kusht që të hyj,
Por, ah, ky qiell rënduaka shumë,
Më lodhën yjet që me dorë i shtyj!

Kërkoj të hyj brenda syve të tu,
Paçka se e kam të vështirë
Të të them: Të dua,
Ti edhe qerpikët i ke hedhur në luftë,
I mbyll ata, që mos t'më shohësh mua!

11 korrik 2018

Unë dhe kitarë që binte vetë
(varianti 2)

Unë të thërras ty në emër,
Dhe kitara bie vetë papritur.
Telat e saj, si asnjëherë tjetër,
E mbushën dhomën me tinguj.

Unë të thërras ty në emër,
Dhe rruga mbushet me jargavanë.
Nuk e di kush e ka pasur fajin
Që nuk u dashuruam ne më parë!

Unë të thërras ty në emër,
Një botë të tërë timen ke pushtuar,
Kitara bie papritur vetë,
Sjell një akord të çakorduar!

Unë të thërras ty në emër,
Dhe kitara bie vetë, pa e prekur,
Unë jam në studion e saj, në zemër,
Edhe i gjallë, edhe i vdekur!

22 shkurt 2018

Zgjim apokaliptik

U zgjova në mëngjes
Dhe pashë që bota kishte ikur.
Domethënë fushat, malet, lumenjtë,
Kish mbetur vetëm një copëz vend për mua,
Dhe një copëz qiell i kadifenjtë!

Gjithçka tjetër ishte arratisur,
Kishte shkuar në një planet tjetër,
Po unë me kë të dashurohem tani,
Me kë do të puthem
Kur s'ka më njerëz?

I kishin marrë me vete edhe shtëpitë,
Gjithçka ishte kthyer në gërmadhë.
O Zot, ndërhyj pak të lutem,
Të na kthejnë siç ishim më parë!

O Zot, unë nuk jam Noeja,
Që e shpëtoi botën me atë varkën,
E ç'të bëj tani
Kur të gjithë janë arratisur,
Unë s'ia di as adresën, të paktën!

O botë, kush të solli në këtë ditë,
Ti kaq e marrë s'ke qenë kurrë më parë!

4 janar 2018

Edhe perënditë e duan lavdinë

Kam filluar të flas vetëm me sytë,
Ata e dinë mirë ç'është dhimbja!
Do desha të të jap pak më tepër dashuri,
Po s'e gjeja dot kujt t'ia hiqja!

Nuk mund t'ia marr dot dashurinë
Atyre që unë vetë ua kam dhënë!
Një erë e grisur kërkon shteg të ikë,
Po shtigjet janë krejt të zënë!

Dua të jem më shumë se ai që dua,
Edhe perënditë e duan lavdinë,
Jeta është e shkurtër sa rrugët e tua,
Jeta është e gjatë sa një vetëtimë!

26 mars 2018

Lashë vetëm një rrugë

I mblodha të gjitha rrugët e njerëzve,
I hodha të gjitha mbi shpinë,
Lashë vetëm një rrugë sa për vete,
(Për gjithë botën ajo më arrin!)

Ngarkuar jam i tëri me mëngjese,
Mbrëmjet më vijnë më vonë,
Por edhe ato, që të mos lodhen,
Mbi shpinën time le të urdhërojnë!

E shihni që unë kam mendje timen,
Dhe dua të bëhet siç dua unë,
Unë edhe rrugën që mbajta për vete,
Do ta kem vetëm me gurë!

Sizifi mban një mal mbi vete,
Unë mbaj rrugë!

8 korrik 2018

Unë të krijoj ty

Edhe kur më mungon, unë të krijoj,
Të çoj atje ku ti kurrë s'humb,
Rrugët i mbaj në krahë
Që të mos i lodh,
Zjarre unë ndez ku të mund!

Ti gjurmë lë ngado që shkon,
Unë eci nëpër to
E ty të marr me vete,
Njërin sup e kam për kokën tënde
Dhe supin tjetër për ty ku të mbështetesh!

Sa pak njerëz që kanë mbetur,
U shpërndanë të gjithë nëpër kontinente,
Shqipëria është më parë këtu
E pastaj ku ka oqeane edhe dete!

Sa pak dashuri që na ka mbetur,
S'kemi se ç't'i japim asnjë tjetre,
Ju që ikni larg keni për ta gjetur,
Pas një viti apo një mijë vjetëve!

4 prill 2018